Kronikë

Katër persona në Klos nuk i binden urdhrit të policisë për të ndaluar! Braktisin mjetin dhe largohen, gjenden maska dhe fishekë në makinë

Katër persona nuk i janë bindur urdhrit të policisë në Klos të Dibrës për të ndaluar. Ngjarja është regjistruar mbrëmjen e së pranë Urës Fshat në Klos.

Fishekët dhe makina e sekuestruar

Redaksia
19 Shkurt, 15:10 | **Përditësimi: 19 Shkurt, 17:09**

DIBËR- Katër persona nuk i janë bindur urdhrit të policisë në Klos të Dibrës për të ndaluar. Ngjarja është regjistruar mbrëmjen e së pranë Urës Fshat në Klos.

Katër personat kanë qenë me një makinë me xhama të zinj dhe policia iu ka kërkuar të ndalojnë por ata janë larguar dhe më pas kanë braktisur mjetin.

LEXO EDHE:
VIDEO/ Përfshihen nga flakët 5 ha pyje dhe kullota në Plan i Bardhë në Klos! Forcat zjarrfikëse ndërhyjnë për të shuar zjarrin

Mjeti ka qenë duke udhëtuar nga Tirana në Dibër dhe pasi katër personat e kanë braktisur janë larguar në drejtim të paditur. Ata kanë përfituar nga errësira dhe kanë arritur të largohen pa rënë në prangat e policisë.

Gjatë kontrollit të ushtruar në mjet janë gjetur kapucë të zinj në formë maske dhe disa fishekë luftarak.

Lajm ne perditesim...

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 16:51

Klos/ Nuk iu bindën urdhrit të policisë për të ndaluar, shpallen në kërkim katër të rinjtë nga Tirana

Katër të rinjtë nga Tirana që nuk iu bindën urdhrit të policisë në Klos për të ndaluar janë identifikuar dhe shpallur në kërkim. Policia ka sekuestruar makinën me të cilën katër të rinjtë po lëvizin, si edhe një kréhër kallashnikovi me 30 fishekë dhe tre kapucë në formë maskash.

"Identifikohen dhe shpallen në kërkim 4 persona nga Tirana që nuk iu bindën urdhrit të Policisë për të ndaluar.

Procedohen penalisht në gjendje të lirë tre shtetas të tjerë, lidhje shoqërore dhe të afërm të shtetasve të shpallur në kërkim: të cilët u gjetën në një banesë të braktisur në fshatin Peshk, njësia Administrative Martanesh.

Sekuestrohet një automjet, një krëhër kallashnikovi me 30 fishekë, një mekanizëm që shërben për bluzje të lëndës narkotike dhe tre kapucë në formë maskash.

Strukturat hetimore të DVP Dibër në bashkëpunim me shërbimet e Komisariatit të Policisë Mat dhe Postën e Policisë Klos, në vijim të punës për kapjen e personave në kërkim, të atyre që qarkullojnë me armë zjarri apo që merrem me aktivitetin kriminal të shpeshdarjes së lëndëve narkotike kanë organizuar pika kontrolli me qëllim godijen e tyre.

Si rezultat në rrugën e Arbrit, në fshatin Shkallë, Bashkia Klos, shërbimet e Policisë i kanë bërë shenjë ndalimi automjetit tip 'Volsëagen', ku udhëtonin 4 shtetas, të cilët nuk i janë bindur urdhrit të punonjësve të policisë për të ndaluar, por janë ndaluar disa metra larg pikës së kontrollit dhe më pas kanë braktisur mjetin duke u larguar me vrap.

Gjatë kontrollit të mjetit është gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një mekanizëm metalik që shërben për bluzje të lëndës narkotike me mbetje të lëndës narkotike e dyshuar canabis sativa, një krëhër kallashnikovi me 30 copë fishek dhe tre kapucë në formë maskash.

Si rezultat i hetimeve të thelluara bazuar dhe në inteligjencë informative u bë e mundur identifikimi dhe shpallja në kërkim e shtetasve :

E.R., D.M., Sh.H., dhe E.Rr., 21 vjeç, të gjithë banues në Tiranë, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Armëbajtje pa leje" dhe "Mosbindja ndaj urdhërit të punonjësit të policisë".

Po në vijim të hetimeve të thelluara shërbimet e Komisariatit të Policisë Bulqizë ushtruan kontrollë në një banesë të braktisur në fshatin Peshk, njësia Administrative Martanesh ku dyshohej se do shkonin katër shtetasit e shpallur në kërkim.

Gjatë kontrollit në këtë banesë shërbimet e Policisë gjetën dhe proceduan penalisht në gjendje të lirë për veprën penale "Prodhim dhe shitja e narkotikëve", tre shtetas të tjerë nga Tirana, konkretisht: E.M., R.T, K.K., 22 vjeç, të tre banues në Tiranë. Nga hetimet rezulton se këta shtetas kanë lidhje shoqërore dhe të afërm me shtetasit e shpallur në kërkim.

Shërbimet e Policisë gjanë kontrollit në banesën ku u gjetën këta tre shtetas gjetën dhe sekuestruan një sasi të vogël canabis sativa që po e përgatitoninë në doza.

Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë vijon punën për zbardhjen dhe dokumentin e plotë të këtij rasti.

Materialet i kaluan Prokurorisë për veprime të mëtejshme", njofton policia.

SLE./Shqiptarja.com

TAGS: Dibër | policia e Dibres

Komentoj

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni sjelljen e opozitës në Kuvend?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Ishte në kërkim për kultivim kanabisi në Mat, në pranga 21-vjeçarë! I sekuestrohen 187 rrënjë
16 Shkurt, 14:18

FOTOT/ Rama: Drejt përfundimit punimet në Urën e Kloshit, do të jetë më e sigurt se më parë
12 Shkurt, 10:56

Blegtori nga Bulqiza me 350 kreré bagëti: Po falimentoj! AZHBR-ja të më ndihmojë për stalla dhe baxho

Mahir Janguli

5 Shkurt, 18:08

Zëri i Amerikës: Ritme të ulëta zhvillimi në qarqet veriore të Shqipërisë
4 Shkurt, 22:44

Mesazhi 'ekzaltues' i Llir Metës: Do ta bëjmë Pukën si Zvicra, PL pranë të rinjve
4 Shkurt, 21:32

24 vjeçari humbi jetën në aksident mbrëmjen e ndërrimit të viteve, pas një muaji nis vendosja e mbrojtëseve anësore në rrugën Bulqizë-Maqellarë
3 Shkurt, 12:51

Dibër, prani ngricash në rrugën e Arbrit, kontraktori nuk ka bërë kriposjen
3 Shkurt, 08:06

Temperaturat nën zero, borë e ngrica në Korçë e Dibër! Rruga e Arbrit dhe aksi Korçë-Ersekë i kalueshëm me zinxhirë
3 Shkurt, 07:57

Denoncimi i Vokshit: Pas datës 20 të çdo muaji, në spitalin e Dibrës s'bëhen analiza se s'ka fonde! Qytetarët të reagojnë me protesta
1 Shkurt, 10:48

Shpërndanin drogë në Bulqizë, arrestohen dy të rinj! Bashkëpunëtori i tyre ia mbath në momentin që policia ndalon makinën (EMRAT)
31 Janar, 09:40

Plagosen me thikë 2 vëllezër në Burrel, mbërrijnë me helikopter në spitalin e Traumës! Në kërkim autori që i goditi (VIDEO)
29 Janar, 15:20

'Sytë e krimit', çmontohen 3 kamera në Memaliaj dhe 1 në Burrel! 2 persona në hetim
28 Janar, 14:24

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kësaj faqeje